

## NJOFTIM PËR SHTYP

### Zgjedhjet e nesërme Presidenciale në Republikën e Moldavisë;

### Aktivistët e KRIIK pjesë e Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të ENEMO-s

Ditën e nesërme, më datë 1 Nëntor 2020, në Republikën e Moldavisë do të mbahen Zgjedhjet Presidenciale. Këto zgjedhje shënojnë herën e katërt të përzgjedhjes me votë popullore të Presidentit të Republikës për këtë vend, që prej shpalljes së pavarësisë nga Bashkimi Sovjetik, në gusht 1991.

Zgjedhjet e nesërme **vijnë në një moment të vështirë për vendin dhe shoqërinë moldave**, të cilët përballen me sfidat e një besimi shumë të ulët të popullit ndaj institucioneve shtetërore dhe sistemit gjyqësor, nivele të larta të korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë, një sistem gjyqësor jo funksional dhe një migracion masiv të qytetarëve.

Mbajtja e zgjedhjeve të besueshme, transparente dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike **është konsideruar një test vendimtar për demokracinë dhe shtetin ligjor nga partnerët ndërkombëtarë të Moldavisë.**

Dinamikat e paqëndrueshme politike, herë pas here janë paraprirë apo kanë ndjekur vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese të vendit. Vendimmarrje kjo që ka marrë kritika jo të pakta, si jo e pavarur dhe me anshmëri politike.

Ndërsa, në raport me përvojën e proceseve zgjedhore, jo vetëm Gjykata Kushtetuese, por i tërë sistemi gjyqësor ka mbartur një rol determinant në mbarëvajtjen e tyre. Në tërësinë e tij, i tërë ky mekanizëm, është manifestuar jo si garant i integritetit zgjedhor, por si një instrument diskrecional në fatin e proceseve zgjedhore.

**Një sfidë specifike në mbarëvajtjen** e deritanishme të fushatës zgjedhore të zhvilluar dhe përgatitjes së këtij procesi zgjedhor është situata e emergjencës së shëndetit publik.

Republika e Moldavisë shënon **një ndër vendet që po përballen me një situatë kritike të pandemisë së virusit të Covid-19**. Situata që pritet të përcaktojë edhe ecurinë e Ditës së nesërme të Zgjedhjeve në raport me pjesëmarrjen e votuesve, apo edhe të problematikave procedurale që mund të pasjellë.

[Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve](#) (MNVZ) në Moldavi i ndërmarrë nga Rrjeti European i Organizatave të Monitorimit të Zgjedhjeve (ENEMO) ka nisur të ndjekë dhe monitorojë ecurinë e këtij procesi zgjedhor që prej muajit shtator të këtij viti.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

Ky MNVZ **përbëhet nga 8 ekspertë anëtarë të Ekipit Qendror, 8 vëzhgues afagjatë si dhe 26 vëzhgues afatshkurtër**, të cilët do të vëzhgojnë ditën e nesërme të votimit, përfshirë numërimin dhe tabelimin e rezultateve, që, sipas sondazheve parashikohet të përbëjë raundin e parë të votimit, pasi asnjë prej kandidatëve nuk pritet të fitojë mbi 50% të votave që në këtë raund.

MNVZ-ja është përgatitur gjithashtu të ndjekë dhe vëzhgojë edhe raundin e dytë të 15 nëntorit, nëse do të ketë një të tillë.

Në [Raportin e Ndërmjetëm të Monitorimit](#) të publikuar më datë 26 tetor 2020, MNVZ-ja vlerësoi ndër të tjera se në përgjithësi legjislacioni zgjedhor **siguron bazat për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, nëse vullnetet e palëve dhe institucioneve nuk mungojnë.**

Megjithatë, **Raporti evidenton mangësi të kuadrit ligjor**, problematika në barazinë e kandidatëve garues përgjatë fushatës zgjedhore si dhe **një mekanizëm gjyqësor pasiv përballë ankimeve të paraqitura.**

MNVZ-ja pritet të paraqesë Deklaratën e Gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake pas Ditës së Zgjedhjeve, nëpërmjet një [Konference për Shtyp](#), të martën më datë 3 Nëntor 2020, ora 11.00 me orën lokale të Moldavisë.

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (**KRIIK**), si pjesë e **ENEMO-s prej vitit 2009 dhe si anëtar i Sekretariatit Drejtues për dy mandate rresht prej vitit 2015**, ka kontribuar në vazhdimësi në kryerjen e MNVZ-ve prej ENEMO-s duke angazhuar aktivistët dhe bashkëpunëtorët e tij.

MNVZ-ja për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Presidenciale të 1 Nëntorit 2020 **shënon Misionin e katërt të Vëzhgimit që ENEMO ka kryer përgjatë këtij viti**, pas atij për vëzhgimin e [Zgjedhjeve Parlamentare të 21 Qershorit 2020](#) në Sërbi, [Zgjedhjeve Parlamentare të 30 Gushtit 2020](#) në Mal të Zi dhe [Zgjedhjeve Lokale të 25 Tetorit 2020](#) në Ukrainë.

Në këtë Mision Ndërkombëtar Vëzhgimi në Moldavi, **KRIIK kontribuon me Zv/Kryetarin e tij z. Dritan Taulla si Shef të Misionit**, me ekspertin e tij ligjor për çështjet zgjedhore **z. Reald Keta, si Analist Ligjor në Ekipin Drejtues të MNVZ-së**, si dhe me një vëzhgues afatgjatë dhe dy vëzhgues afatshkurtër.

Angazhimi aktiv i KRIIK në këto Misione Ndërkombëtare, nëpërmjet një trupe aktivistësh dhe bashkëpunëtorësh, përpos qëllimit për të kontribuar në rritjen e standardeve të zgjedhjeve dhe të vetë demokracisë në vendet me demokraci të zhvillim, përbën një përvojë domethënëse dhe të rëndësishme **për rritjen e ekspertizës dhe të kapaciteteve njerëzore në ndërtimin, ndjekjen dhe monitorimin cilësor të proceseve zgjedhore dhe proceseve të tjera demokratike** edhe në vendin tonë.

***Tiranë, më 31 Tetor 2020!***

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania